

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 21.06.2025

1. Më poshtë janë pasqyrat financiare të veçanta të Munger sh.a dhe dy kompanive në të cilat ka investuar të cilat gjithashtu operojnë në të njëjtën industri.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024**

|                                             | Munger sh.a     | Lynch sh.a      | Icahn sh.a      |
|---------------------------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|
|                                             | €'000           | €'000           | €'000           |
| Shitjet                                     | 92,500          | 48,000          | 30,000          |
| Kosto e shitjeve                            | <u>(70,500)</u> | <u>(36,000)</u> | <u>(18,000)</u> |
| Fitimi bruto                                | 22,000          | 12,000          | 12,000          |
| Kostot e shpërndarjes                       | (2,500)         | (1,200)         | (1,000)         |
| Shpenzimet administrative                   | (5,500)         | (2,400)         | (2,000)         |
| Kosto financiare                            | (100)           | -               | -               |
| Fitimi para tatimit                         | 13,900          | 8,400           | 9,000           |
| Tatimi në fitim                             | <u>(3,900)</u>  | <u>(1,600)</u>  | <u>(2,200)</u>  |
| <b>Fitimi për vitin</b>                     | <b>10,000</b>   | <b>6,800</b>    | <b>6,800</b>    |
| <i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i> |                 |                 |                 |
| Përfitimi në rivlerësimin e tokës           | <u>500</u>      | <u>-</u>        | <u>-</u>        |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>  | <b>10,500</b>   | <b>6,800</b>    | <b>6,800</b>    |

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024**

|                                                   | Munger sh.a   | Lynch sh.a    | Icahn sh.a    |
|---------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|
|                                                   | €'000         | €'000         | €'000         |
| <b>Pasuritë</b>                                   |               |               |               |
| Pasuritë jo-qarkulluese:                          |               |               |               |
| Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet         | 18,300        | 18,900        | 15,000        |
| Investimet                                        | <u>12,600</u> | <u>-</u>      | <u>-</u>      |
|                                                   | 30,900        | 18,900        | 15,000        |
| Pasuritë qarkulluese                              | <u>12,500</u> | <u>2,400</u>  | <u>3,000</u>  |
| <b>Total pasuritë</b>                             | <b>43,400</b> | <b>21,300</b> | <b>18,000</b> |
| <b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>                     |               |               |               |
| <i>Ekuiteti:</i>                                  |               |               |               |
| Aksionet e zakonshme prej €1 secila               | 15,000        | 5,000         | 6,000         |
| Rezerva e rivlerësimit të tokës – 31 dhjetor 2024 | 2,000         | -             | -             |
| Rezervat e tjera – 1 janar 2024                   | 500           | -             | -             |
| Fitimet e mbajtura                                | <u>12,900</u> | <u>9,500</u>  | <u>5,000</u>  |
|                                                   | 30,400        | 14,500        | 11,000        |
| <i>Detyrimet afatgjata:</i>                       |               |               |               |
| 6% nota kredie                                    | 3,000         | -             | -             |
| Detyrimet afatshkurta                             | <u>10,000</u> | <u>6,800</u>  | <u>7,000</u>  |
| <b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>               | <b>43,400</b> | <b>21,300</b> | <b>18,000</b> |

Informatat e mëposhtme janë të rëndësishme:

- i) Me 1 shtator 2024, Munger sh.a bleu 80% të kapitalit aksionar të Lynch sh.a. Konsiderata e blerjes përbëhej nga dy elementë: një shkëmbim aksionesh prej tre aksionesh në Munger sh.a për çdo pesë aksione të blera në Lynch sh.a dhe emetimi i notave të kredisë me interes 6% prej €100 për çdo 500 aksione të blera në Lynch sh.a. Emetimi i aksioneve nuk është regjistruar ende nga Munger sh.a, por emetimi i notave të kredisë është regjistruar. Në datën e blerjes, aksionet në Munger sh.a kishin një vlerë tregu prej €5 secila dhe aksionet e Lynch sh.a kishin një çmim në bursë prej €3.50 secila.  
  
Munger sh.a kishte blerë më parë 2.4 milionë aksione të Icahn sh.a në bursë me një çmim prej €1.50 për aksion më 1 korrik 2024.
- ii) Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive të Lynch sh.a ishin të barabarta me vlerat e tyre kontabël me përjashtim të pronës së saj. Kjo kishte një vlerë të drejtë prej €1.2 milionë nën vlerën e saj kontabël. Kjo do të rezultonte në një ulje të zhvlerësimit (në koston e shitjeve) prej €50,000 në periudhën pas blerjes. Lynch sh.a nuk e ka përfshirë këtë ndryshim të vlerës në pasqyrat e saj financiare të veçanta.
- iii) Është politikë e grupit Munger sh.a të rivlerësojë të gjitha pronat në vlerën aktuale në çdo fundvit. Më 31 dhjetor 2024, vlera e pronës së Lynch sh.a ishte e pandryshuar nga vlera e saj në momentin e blerjes, por elementi i tokës së pronës së Munger sh.a ishte rritur në vlerë për €500,000 siç tregohet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.
- iv) Shitjet nga Lynch sh.a te Munger sh.a gjatë gjithë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2024 ishin €12 milionë (€1 milion çdo muaj) . Lynch aplikoi një marzhë mbi kosto prej 25% në këto shitje. Munger sh.a më 31 dhjetor 2024 kishte €2 milionë (me kosto për Munger sh.a) stoqe që ishte furnizuar në periudhën pas blerjes nga Lynch sh.a.
- v) Në dhjetor 2024, Munger sh.a i shiti mallra Icahn sh.a për €2,000,000, duke arritur kështu një fitimi prej 25% mbi kosto. E gjithë sasia e mallrave mbeti e pashitur dhe u përfshi në stoqet e Icahn sh.a më 31 dhjetor 2024.
- vi) Investimet e Munger sh.a përfshijnë disa investime të klasifikuara si të matura sipas vlerës reale përmes të ardhurave të tejra gjithëpërfshirëse që janë rritur në vlerë me €300,000 gjatë vitit. Rezervat e tjera të ekuitetit lidhet me këto investime dhe bazohet në vlerën e tyre më 31 dhjetor 2023. Nuk ka pasur blerje ose shitje të asnjërit prej këtyre investimeve gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2024.
- vii) Është politikë e Munger sh.a të vlerësojë interesin jo-kontrollues me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Për këtë qëllim, çmimi i aksionit të Lynch sh.a në atë datë mund të konsiderohet si përfaqësues i vlerës së drejtë të aksioneve të mbajtura nga interesi jo-kontrollues.
- viii) Në fund të vitit u përcaktua se 10% e zërit të mirë që lidhej me blerjen e Lynch sh.a ishte dëmtuar.

**Kërkohet:**

- a) Përgatiteni pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 për grupin Munger sh.a.  
(10 pikë)
- b) Përgatiteni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare me 31 dhjetor 2024 për grupin Munger sh.a.  
(10 pikë)

(Total: 20 pikë)

1.

(a)

**Grupi Munger sh.a**

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse  
për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024**

|                                                                                | €'000           |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Shitjet $(92,500 + (48,000 \times 4/12) - 4,000 \text{ shitjet ndër-grupore})$ | 104,500         |
| Kosto e shitjeve (L12)                                                         | <u>(78,850)</u> |
| Fitimi bruto                                                                   | 25,650          |
| Kostot e shpërndarjes $(2,500 + (1,200 \times 4/12))$                          | (2,900)         |
| Shpenzimet administrative $(5,500 + (2,400 \times 4/12))$                      | (6,300)         |
| Dëmtimi i zërit të mirë (L16)                                                  | <u>(527)</u>    |
| Neto fitimi operativ                                                           | 15,923          |
| Pjesa e fitimit të ortakërisë (L17)                                            | <u>1,200</u>    |
| Neto fitimi para interesit dhe tatimit                                         | 17,123          |
| Kosto financiare                                                               | <u>(100)</u>    |
| Neto fitimi para tatimit                                                       | 17,023          |
| Tatimi ne fitim $(3,900 + (1,600 \times 4/12))$                                | <u>(4,433)</u>  |
| <b>Neto fitimi për vitin</b>                                                   | <b>12,590</b>   |
| <i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>                                    |                 |
| Përfitimi nga investime VRPATGJ                                                | 300             |
| Përfitimi nga rivlerësimi i pronës                                             | <u>500</u>      |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                                     | <b>13,390</b>   |
| <i>Neto fitimi i atribuar tek:</i>                                             |                 |
| Mbajtësit e ekuitetit të prindit                                               | 12,312          |
| Interesi jo-kontrollues (L13)                                                  | <u>278</u>      |
|                                                                                | <b>12,590</b>   |
| <i>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar tek:</i>                       |                 |
| Mbajtësit e ekuitetit të prindit $(12,312 + 300 + 500)$                        | 13,112          |
| Interesi jo-kontrollues (L13)                                                  | <u>278</u>      |
|                                                                                | <b>13,390</b>   |

**Shënim:** Fitimet e Lynch sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 prej €6.8 milionë janë €4.533 milionë  $(6,800 \times 8/12)$  para blerjes dhe €2.267 milionë  $(6,800 \times 4/12)$  pas blerjes.

(b)

**Grupi Munger sh.a**

**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024**

€'000

**Pasuritë**

*Pasuritë jo-qarkulluese*

Prona, impiantet e prodhimit dhe pajisjet (L14) 36,050

Zëri i mirë (L16) 4,740

Investimet në ortakëri (L19) 4,800

Investime VRPATGJ (12,600 – [3,600+800] + 300 përfitim) 8,500

54,090

Pasuritë qarkulluese (12,500 + 2,400 – 400) 14,500

**Total pasuritë 68,590**

**Ekuiteti dhe detyrimet**

Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit:

Aksionet e zakonshme prej €1 secila (15,000+((3/5 x 4,000)) 17,400

Premia e aksioneve ((3/5 x 4,000) x 5-1) 9,600

Rezerva e rivlerësimit të tokës 2,000

interesi jo-kontrollues (500 + 300) 800

Fitimet e mbajtura (L17) 15,212

45,012

Interesi jo-kontrollues (L18) 3,778

Total ekuiteti 48,790

*Detyrimet afatgjata:*

6% nota kredie 3,000

Detyrimet afatshkurta (10,000 + 6,800) 16,800

**Total ekuiteti dhe detyrimet 68,590**

**Llogaritjet në €'000**

**1. Struktura e grupit**

|             | <b>Lynch sh.a</b> |         | <b>Icahn sh.a</b> |  |
|-------------|-------------------|---------|-------------------|--|
| Munger sh.a | 80%               | (2.4/6) | 40%               |  |
| IJK         | 20%               |         |                   |  |
| Tjerët      |                   |         | 60%               |  |
|             | 100%              |         | 100%              |  |

**2. Kosto e shitjeve**

|                               |               |
|-------------------------------|---------------|
| Munger sh.a                   | 70,500        |
| Lynch sh.a (36,000 x 4/12)    | 12,000        |
| shitjet ndër-grupore          | (4,000)       |
| FPR në stoqe (2,000 x 25/125) | 400           |
| Zhvlerësimi shtesë            | (50)          |
|                               | <b>78,850</b> |

### 3. Neto fitimi i vitit i atribuar tek interesi jo-kontrollues

|                                                           |              |
|-----------------------------------------------------------|--------------|
| Fitimet pas blerjes të Lynch sh.a ( $6,800 \times 4/12$ ) | 2,267        |
| FPR në stoqe ( $2,000 \times 25/125$ )                    | (400)        |
| Zhvleresimi shtesë                                        | 50           |
| Dëmtimi i zërit të mirë                                   | (527)        |
| Fitimet pas blerjes të korigjuara                         | <u>1,390</u> |
| Interesi jo-kontrollues ( $20\% \times 1,390$ )           | 278          |

### 4. Pasuritë jo-qarkulluese

|                               |           |
|-------------------------------|-----------|
| Munger                        | 18,300    |
| Lynch                         | 18,900    |
| VD në blerje (rënie)          | (1,200)   |
| Zhvleresimi shtesë (zvogëlim) | <u>50</u> |
|                               | 36,050    |

### 5. Konsiderata e blerjes

#### a. Këmbimi i aksioneve:

Nr. i aksioneve në Lynch sh.a =  $0.8 \times 5,000 = 4,000$  aksione

Nr. i aksioneve të Munger sh.a të këmbyerat =  $3/5 \times 4,000 = 2,400$  aksione

Vlera e aksioneve të këmbyerat =  $2,400 \times €5 = €12,000$

#### b. Nota e kreditit:

€100 notë kredie në këmbim për çdo 500 aksione të blera në Lynch

Nr. i aksioneve në Lynch sh.a =  $0.8 \times 5,000 = 4,000$  aksione

Nr. i notave kreditit të këmbyerat =  $4,000/500 = 8$

Shuma e notave kreditit të këmbyerat =  $8 \times €100 = €800$

### 6. Zëri i mirë në Lynch sh.a

Investimi sipas kostos:

|                                                       |              |
|-------------------------------------------------------|--------------|
| Këmbimi i aksioneve ( $(3/5 \times 4,000) \times 5$ ) | 12,000       |
| Nota e kredisë ( $(4,000/500 \times €100)$ )          | 800          |
| VD e IJK-së [ $0.2 \times 5,000 \times €3.5$ ]        | <u>3,500</u> |
|                                                       | 16,300       |

Minus neto pasuritë e blera:

|                                                                         |                 |
|-------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Aksionet e zakonshme                                                    | (5,000)         |
| Fitimet e mbajtura para blerjes ( $9,500 - 6,800 + 6,800/12 \times 8$ ) | (7,233)         |
| Korigji i VD të pronës                                                  | <u>1,200</u>    |
| Neto pasuritë në datën e blerjes                                        | <u>(11,033)</u> |
| Zëri i mirë ( $16,300 - 11,033$ )                                       | 5,267           |
| Dëmtimi ( $10\% \times 5,267$ )                                         | <u>(527)</u>    |
| <b>Saldo e zërit të mirë me 31 dhjetor 2024</b>                         | <b>4,740</b>    |

**7. Fitimet e mbajtura të konsoliduara**

|                                                                  |               |
|------------------------------------------------------------------|---------------|
| Fitimet e mbajturat të Munger sh.a                               | 12,900        |
| Fitimet e mbajtura të Lynch sh.a pas blerjes                     |               |
| [(2,267 – 400 FPR – 527 dëmtimi + 50 zhvl shtesë) x 80%]         | 1,112         |
| Fitimi i ortakërisë pas blerjes [(6,800 x 0.5) – 400 FPR) x 0.4] | <u>1,200</u>  |
|                                                                  | <b>15,212</b> |

**8. Interesi jo-kontrollues në pasqyrene pozitës financiare**

|                                                             |              |
|-------------------------------------------------------------|--------------|
| Në datën e blerjes (5,000 x 0.2 x 3.5)                      | 3,500        |
| Fitimet pas blerjes nga pasqyra e fitimit ose humbjes (L13) | <u>278</u>   |
|                                                             | <b>3,778</b> |

**9. Investimet në ortakëri**

|                                |              |
|--------------------------------|--------------|
| Kosto (2,400 x 1.5)            | 3,600        |
| Fitimet pas blerjes            | 1,360        |
| FPR (0.4 x 25/125 x 2,000,000) | <u>(160)</u> |
|                                | <b>4,800</b> |

**10. Fitimet e mbajtura në blerje**

|                                                              | <b>Lynch sh.a</b> | <b>Icahn sh.a</b> |
|--------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------|
| Fitimet e mbajtura me 31 dhjetor 2024                        | 9,500             | 5,000             |
| Fitimi i vitit                                               | <u>(6,800)</u>    | <u>(6,800)</u>    |
| Fitimet e mbajtura me 1 janar 2024                           | 2,700             | (1,800)           |
| Fitimi nga 1 janar 2024 deri me 31 gusht 2024 (6,800 x 8/12) | 4,533             | -                 |
| Fitimi nga 1 korrik 2024 deri me 31 dhjetor 2024             | <u>-</u>          | <u>3,400</u>      |
| Fitimet e mbajtura në blerje                                 | <b>7,233</b>      | <b>1,600</b>      |

2.

a) Informacioni i mëposhtëm lidhet me skemën e pensioneve të Livermore sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024:

|                                                              | €'000   |
|--------------------------------------------------------------|---------|
| Pasuritë e planit me 1 janar 2024                            | 96,000  |
| Detyrimet e përfitimeve të paracaktuara me 1 janar 2024      | 100,000 |
| Kosto e shërbimit për vitin deri me 31 dhjetor 2024          | 8,000   |
| Norma e skontimit me 1 janar 2024                            | 10%     |
| Humbja nga rimatja për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024 | 4,000   |
| Kostoja e shërbimeve të kaluara me 1 janar 2024              | 6,000   |

Shpenzimet e pensioneve nuk janë përfshirë në të ardhurat totale gjithëpërfshirëse pasi kontabilisti i kompanisë nuk është ende i kualifikuar dhe nuk ka njohuri të mjaftueshme mbi SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*.

**Kërkohet:**

**Tregoni se si do të kontabilizohet skema e pensioneve mësipër sipas SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*, duke përfshirë ekstraktet përkatëse të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024. (5 pikë)**

b) Rowe Price sh.a është një entitet i specializuar në importimin e një game të gjerë artikujsh jo-ushqimorë dhe shitjen e tyre tek shitësit me pakicë. X është Drejtor Ekzekutiv në Rowe Price sh.a dhe themelues i saj dhe ka në pronësi 40% të aksioneve të ekuitetit të Rowe Price sh.a:

- i) Klienti më i madh i Rowe Price sh.a., Z, përbën 35% të të ardhurave të Rowe Price sh.a. Z sapo ka përfunduar negociatat me Rowe Price sh.a. për një zbritje speciale prej 5% në të gjitha shitjet.
- ii) Gjatë periudhës kontabël, X bleu një pronë nga Rowe Price sh.a për €500,000. Rowe Price sh.a kishte deklaruar më parë si tepricë për nevojat të saj dhe e kishte vlerësuar atë në €750,000.
- iii) Djali i X-it, Y, është drejtor në një bankë. Gjatë periudhës kontabël, banka i dha Rowe Price sh.a. €2 milionë si kredi të pasiguruar me një normë interesi të favorshme.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni, me arsye, masën në të cilën secili prej transaksioneve të mësipërme duhet të klasifikohet dhe të shpaloset në pajtim me IAS 24 *Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara* në pasqyrat financiare të Rowe Price sh.a për periudhën. (4 pikë)**

c) Tepper sh.a bleu një biznes taksi më 1 janar 2024 për €230,000. Vlera e pasurive të biznesit në atë datë bazuar në çmimin neto të shitjes ishte si më poshtë:

|                         | €'000       |
|-------------------------|-------------|
| Veturat                 | 120         |
| Pasuritë e patrupëzuara | 30          |
| Llogaritë e arkëtueshme | 10          |
| Paraja                  | 50          |
| Llogaritë e pagueshme   | <u>(20)</u> |
|                         | 190         |

Më 1 shkurt 2024, biznesit të taksive iu vodhën tre (3) vetura. Vlera neto e shitjes së këtyre veturave ishte €30,000 dhe për shkak të mos-shpalosjes të një rreziku të caktuar për kompaninë e sigurimeve, biznesi ishte i pasiguruar. Si rezultat i kësaj ngjarjeje, Tepper sh.a dëshiron të njohë një humbje nga dëmtimi prej €45,000, duke përfshirë humbjen e veturave të vjedhura për shkak të rënies së vlerës së njësisë gjeneruese të parave, që është biznesi i taksive.

Më 1 mars 2024, një kompani rivale e taksive filloi biznesin në të njëjtën zonë. Parashikohet që të ardhurat e biznesit të Tepper sh.a do të ulen me 25%, duke çuar në një rënie të vlerës aktuale në përdorim të biznesit, e cila llogaritet në €155,000. Vlera neto e shitjes së licencës së taksive ka rënë në €25,000 si rezultat i operatorit rival të taksive. Vlerat neto të shitjes së pasurive të tjera kanë mbetur të njëjta që nga 1 janari 2024.

#### Kërkohet:

**Rekomandoni se si Tepper sh.a duhet ta kontabilizojë transaksionin e mësipërm në pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNK 36 Dëmtimi i pasurive.** (6 pikë)

d) Burry sh.a pati shpenzimet e mëposhtme gjatë vitit:

|                                                                                                                        | €'000     | €'000 |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-------|
| Licencë për të ushtruar aktivitet për 10 vjet nga 1 janar 2024                                                         |           | 400   |
| Kostot e shkaktuara në planifikimin e një faqe interneti për një produkt të ri (Uebfaqja do të krijohet në vitin 2025) |           | 40    |
| Blerja e 300 kompjuterëve personalë (PCs) me 1 korrik 2024 (Jetë e dobishme trevjeçare).                               |           |       |
| Total kosto:                                                                                                           |           |       |
| 300 PC (duke përjashtuar sistemin operativ)                                                                            | 480       |       |
| Sistemi operativ Windows për 300 PC për 3 vite                                                                         | 60        |       |
| Programi i Microsoft Office për 300 PC për 3 vite                                                                      | <u>48</u> | 588   |
| Trajnim fillestar për stafin e ri                                                                                      |           | 30    |

Burry sh.a zotëron të drejtat për një gamë të njohur librash, të cilat i bleu nga një entitet tjetër për €180,000 disa vite më parë. Të drejtat nuk u amortizuan pasi u është atribuar një jetë e dobishme e pacaktuar. Librat janë ende shumë të popullarizuar, kështu që nuk ka pasur nevojë për humbje nga dëmtimi dhe u vlerësuan nga një vlerësues i pavarur në €280,000 në vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024.

Politika e kompanisë është të përdorë modelin e rivlerësimit për pasuritë e patrupëzuara aty ku një vlerësim tregu është i disponueshëm dhe i lejuar.

**Kërkohet:**

**Rekomandoni me llogaritje të përshtatshme vlerën kontabël të pasurive të patrupëzuara në fund të vitit 31 dhjetor 2024 sipas udhëzimeve të dhëna në SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara*. (5 pikë)**

## 2.

### a) Shpenzimet e pensioneve

Shpenzimet e pensioneve të njohura për vitin do të ishin:

|                                                                      | €'000        |
|----------------------------------------------------------------------|--------------|
| Kosto e shërbimit aktual                                             | 8,000        |
| Kosto neto e interesit (10% of €100m – €96m)                         | 400          |
| Kosto e shërbimit të kaluar                                          | <u>6,000</u> |
| Neto kosto e shërbimit e njohur në fitim ose humbje                  | 14,400       |
| Rimatjet në TTGJ                                                     | <u>4,000</u> |
| Neto kosto për vitin e njohur në total të ardhurat gjithëpërfshirëse | 18,400       |

SNK 19 nuk specifikon në fakt se ku duhet të paraqitet kostoja e shërbimit dhe kostoja neto e interesit. Si rezultat, është e pranueshme të përfshihet kostoja neto e interesit në kostot financiare.

SNK 19 thotë se kostoja e shërbimit të kaluar duhet të njihet menjëherë dhe kostoja e shërbimit të kaluar do të përfshihet në detyrimin e përfitimeve të përcaktuara më 1 janar 2024. Kështu, nuk ka nevojë të llogaritet një kosto interesi mbi koston e shërbimit të kaluar.

### Ekstraktet e pasqyrave financiare

|                                                     |              |
|-----------------------------------------------------|--------------|
| <b>Pasqyra e fitimit ose humbjes</b>                | <b>€'000</b> |
| Neto kosto e shërbimit e njohur në fitim ose humbje | (14,400)     |
| <b>TTGJ</b>                                         |              |
| Rimatjet në TTGJ                                    | (4,000)      |

### b) Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara

Sipas SNK 24 *Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara*, një klient me të cilin një entitet kryen një vëllim të konsiderueshëm biznesi nuk është një palë e ndërlidhur vetëm për shkak të varësisë ekonomike që rezulton. Z nuk është palë e ndërlidhur dhe zbritja e negociuar nuk ka nevojë të shpaloset.

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse ka një interes në entitet që i jep atij ndikim të rëndësishëm mbi entitetin. Pala është e ndërlidhur me një entitet nëse është anëtar i personelit kryesor të menaxhimit të entitetit. Si anëtar themelues dhe aksionar kryesor që mban 40% të aksioneve X është në gjendje të ushtrojë ndikim të rëndësishëm dhe është një palë e ndërlidhur e Rowe Price sh.a. X është gjithashtu një palë e ndërlidhur pasi është president i Rowe Price sh.a. Ai është anëtar i personelit kryesor të menaxhimit të Rowe Price sh.a. Shitja e pronës për €500,000 do të duhet të shpaloset, së bashku me vlerësimin si një transaksion me palë të ndërlidhur.

Ofruesit e financimit nuk janë palë të ndërlidhura thjesht për shkak të marrëdhënieve të tyre normale me entitetin. Megjithatë, nëse një palë është një anëtar i ngushtë i familjes së ndonjë individi të kategorizuar si palë e ndërlidhur, ata janë gjithashtu një palë e ndërlidhur. Meqenëse Y është djali i X dhe X është një palë e lidhur, Y është gjithashtu një palë e ndërlidhur. Kredia nga banka do të duhet të shpaloset së bashku me detajet e Y dhe përfshirjen e tij në bankë.

**c) Tepper sh.a do ta njihte humbjen nga zhvlerësimi në mënyrën e mëposhtme:**

Kur identifikohet humbja nga dëmtimi, ajo duhet të njihet menjëherë si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kur humbja nga dëmtimi lidhet me një grup pasurish, zakonisht, humbja nga dëmtimi duhet t'u ndahet me përparësi atyre pasurive që kanë vlerësimet më subjektive. Dëmtimi i identifikuar në këtë mënyrë zakonisht duhet t'i ndahet emrit të mirë, më pas pasurive jo-materiale për të cilat nuk ka treg aktiv, së treti pasurive çmimi neto i shitjes së të cilave është më i vogël se vlera e tyre kontabël dhe së fundmi çdo pasurie të prekshme në njësi.

**Me 1 shkurt 2024**

|                                            | <b>1 janar 2024</b> | <b>Humbja nga dëmtimi</b> | <b>1 shkurt 2024</b> |
|--------------------------------------------|---------------------|---------------------------|----------------------|
|                                            | <b>€'000</b>        | <b>€'000</b>              | <b>€'000</b>         |
| Emri i mirë                                | 40                  | (15)                      | 25                   |
| Pasuritë e patrupëzuara (Licenca e taksit) | 30                  | 0                         | 30                   |
| Veturat                                    | 120                 | (30)                      | 90                   |
| Pasuritë tjera                             | <u>40</u>           | <u>0</u>                  | <u>40</u>            |
|                                            | <b>230</b>          | <b>(45)</b>               | <b>185</b>           |

Humbja nga dëmtimi prej €30,000 njihet së pari për automjetet e vjedhura dhe pjesa tjetër (€15,000) i atribuohet emrit të mirë.

**Me 1 mars 2024**

|                         | <b>1 shkurt 2024</b> | <b>Humbja nga dëmtimi</b> | <b>1 mars 2024</b> |
|-------------------------|----------------------|---------------------------|--------------------|
|                         | <b>€'000</b>         | <b>€'000</b>              | <b>€'000</b>       |
| Emri i mirë             | 25                   | (25)                      | -                  |
| Pasuritë e patrupëzuara | 30                   | (5)                       | 25                 |
| Veturat                 | 90                   | (0)                       | 90                 |
| Pasuritë tjera          | <u>40</u>            | <u>0</u>                  | <u>40</u>          |
|                         | <b>185</b>           | <b>(30)</b>               | <b>155</b>         |

**d)**

**Pasuritë e patrupëzuara**

|                                                                                                               | <b>€'000</b>   |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| Licenca (400 – (400/10 vite))                                                                                 | 360,000        |
| Planifikimin e një faqe interneti – shpenzim                                                                  | 0              |
| Kompjuterët – Pasuritë e trupëzuara (SNK 16)                                                                  | 0              |
| Sistemi operativ – Pasuritë e trupëzuara<br>(kompjuterët nuk mund të funksionojnë pa të – IAS 38 paragrafi 4) | 0              |
| Microsoft Office (48 – (48/3 x 6/12))                                                                         | 40,000         |
| Trajnimi- shpenzim (SNK 38 para 69(c))                                                                        | 0              |
| Librat (nuk mund të rivlerësohet - mungesë tregu aktiv)                                                       | <u>180,000</u> |
|                                                                                                               | <b>580,000</b> |

3.

a) Abrams sh.a është një kompani e listuar në bursë e cila përgatit pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Më 1 janar 2024, Abrams sh.a bleu një tokë për €10 milionë (duke përfshirë kostot ligjore prej €4 milionë) me qëllim ndërtimin e një impianti të ri të prodhimit. Punimet e ndërtimit filluan më 1 shkurt 2024. Abrams sh.a pati kostot e mëposhtme në lidhje me ndërtimin e tij:

- i) Shpenzime të përgjithshme të shkaktuara drejtpërdrejt në ndërtimin e impianti të prodhimit – €100,000 në muaj.
- ii) Përgatitja dhe nivelimi i tokës – €300,000.
- iii) Blerja e materialeve për ndërtimin – €6.08 milion në total.
- iv) Kostot e punësimit të punëtorëve të ndërtimit – €200,000 në muaj.
- v) Shpenzimet e përgjithshme të vazhdueshme të alokuara për projektin e ndërtimit duke përdorur modelin normal të alokimit të shpenzimeve të përgjithshme të Abrams sh.a – €150,000 në muaj.
- vi) Të ardhurat e përfituara gjatë përdorimit të përkohshëm të ambienteve të impiantit të prodhimit si parking gjatë periudhës së ndërtimit – €540,000.
- vii) Kostot e zhvendosjes së punonjësve për të punuar në impiantin e ri të prodhimit – €340,000.
- viii) Shpenzimet e ceremonisë së hapjes më 30 tetor 2024– €550,000.

Impianti i prodhimit u përfundua më 31 gusht 2024 dhe prodhimi filloi më 1 nëntor 2024. Jeta e përgjithshme e dobishme e ndërtesës së impiantit të prodhimit u vlerësua në 40 vjet nga data e përfundimit. Megjithatë, vlerësohet se çatia do të duhet të zëvendësohet 20 vjet pas datës së përfundimit dhe se kostoja e zëvendësimit të çatisë me çmimet aktuale do të jetë 30% e kostos totale të ndërtesës. Në fund të periudhës 40-vjeçare, Abrams sh.a ka një detyrim të zbatueshëm ligjërisht për të demoluar fabrikën dhe për ta rikthyer vendin në gjendjen e tij origjinale. Drejtorët vlerësojnë se kostoja e demolimit pas 40 vitesh (bazuar në çmimet mbizotëruese pas 40 vitesh) do të jetë 20 milionë euro. Një normë skontimi vjetore e rregulluar sipas rrezikut që është e përshtatshme për këtë projekt është 8%. Vlera aktuale e 1 euros e pagueshme pas 40 vitesh me një normë vjetore të skontimit prej 8% është 4.6 cent.

Ndërtimi i impiantit të prodhimit u financua pjesërisht nga një kredi prej €17.5 milionë e marrë më 1 janar 2024. Kredia ishte me një normë interesi vjetore prej 6%. Gjatë periudhës 1 janar 2024 deri më 30 maj 2024 (kur të ardhurat nga kredia ishin përdorur plotësisht për të financuar ndërtimin), Abrams sh.a mori të ardhura nga investimi prej €100,000 nga investimi i përkohshëm i të ardhurave.

**Kërkohet:**

**Përcaktoni dhe shpjegoni trajtimin e secilës prej shumave në llogaritjen e vlerës kontabël të impiantit të prodhimit që duhet të jetë në pasqyrën e pozitës financiare të Abrams më 31 dhjetor 2024.**

**(15 pikë)**

**b)** Është sugjeruar që analiza e koeficientëve nuk është domosdoshmërisht mënyra më e mirë për të vlerësuar performancën e një kompanie..

**Kërkohet:**

- i) Përshkruani DY përdorime të koeficientëve përveç vlerësimit të performancës.  
(2 pikë)
- ii) Shpjegoni TRE kufizime të përdorimit të koeficientëve në vlerësimin e performancës financiare.  
(3 pikë)

3.

(a) Llogaritja e kostos së impiantit

| Përshkrimi                                           | Përfshirë në PPIPP<br>€'000 | Shpjegimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|------------------------------------------------------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Blerja e tokës                                       | 10,000                      | Si blerja e tokës ashtu edhe kostot ligjore që lidhen me të janë kosto direkte të ndërtimit të impiantit të prodhimit.                                                                                                                                                                                    |
| Përgatitja dhe nivelimi i tokës                      | 300                         | Kosto direkte e ndërtimit të impiantit të prodhimit                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Materialet                                           | 6,080                       | Kosto direkte e ndërtimit të impiantit të prodhimit                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Kostot e punësimit të punëtorëve të ndërtimit        | 1,400                       | Kosto direkte e ndërtimit të impiantit të prodhimit për një periudhë shtatë mujore                                                                                                                                                                                                                        |
| Shpenzime e përgjithshme direkte                     | 700                         | Kosto direkte e ndërtimit të impiantit të prodhimit për një periudhë shtatë mujore                                                                                                                                                                                                                        |
| Shpenzime të përgjithshme të alokuara                | -                           | Nuk është një kosto e drejtpërdrejtë e ndërtimit                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Të ardhura nga përdorimi si parking                  | -                           | Nuk është thelbësore për ndërtimin, prandaj njihet drejtpërdrejt në fitim ose humbje                                                                                                                                                                                                                      |
| Kostot e zhvendosjes së punonjësve                   | -                           | Nuk është një kosto e drejtpërdrejtë e ndërtimit                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Ceremonia e hapjes                                   | -                           | Nuk është një kosto e drejtpërdrejtë e ndërtimit                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Kosto financiare                                     | 700                         | Kapitalizimi i kostos së interesit të shkaktuar gjatë një periudhe tetë mujore (blerja e tokës do të shkaktonte kapitalizim)                                                                                                                                                                              |
| të ardhura nga investimi i përkohshëm i të ardhurave | (100)                       | Duhet të kompensohet me shumën e kapitalizuar                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Kostoja e demolimit e njohur si provizion            | 920                         | Kur një detyrim duhet të njihet si pjesë e koston fillestare                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Total</b>                                         | <b>20,000</b>               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Llogaritja e zhvlerësimit të akumuluar</b>        |                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Shuma totale e zhvlerësueshme                        | 10,000                      | E gjithë kostoja neto e financimit prej 600 (700 – 100) është alokuar në shumën e zhvlerësueshme. Gjithashtu është e pranueshme të zvogëlohet duke ndarë një pjesë në elementin e tokës së zhvlerësueshme. Pra 300 për token dhe 300 për ndërtesën. Në këtë rast shuma e zhvlerësueshme do të ishte 9,700 |
| Zhvlerësimi duhet të jetë në dy pjesë                |                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| - Zhvlerësimi i çatisë                               | 50                          | $10,000 \times 30\% \times 1/20 \times 4/12$                                                                                                                                                                                                                                                              |
| - Zhvlerësimi i pjesës tjetër                        | 58                          | $10,000 \times 70\% \times 1/40 \times 4/12$                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Total zhvlerësimi                                    | 108                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Llogaritja e vlerës kontabël</b>                  | <b>19,892</b>               | <b>20,000 – 108</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

**b)**

**i) Përdorimet e koeficientëve (kërkohen vetem 2):**

- Koeficientët përdoren për të shprehur marrëdhëniet logjike që ekzistojnë midis disa zërave në pasqyrat financiare.
- Koeficientët përdoren gjithashtu për të vlerësuar pozitën e likuiditetit dhe gjendjen financiare të një kompanie gjatë një periudhe, si dhe me kompanie të tjera të ngjashme.
- Koeficientët ofrojnë një mjet më të mirë krahasimi sesa vlerat absolute të matjes financiare ose operacionale.
- Koeficientët janë të dobishme në vlerësimin e efikasitetit në menaxhimin e pasurive të entitetit.
- Koeficientët japin një tregues nëse është e sigurt të investohet në një entiteti.
- Është gjithashtu i dobishëm në përmbledhjen e informacionit të përmbajtur në pasqyrat financiare dhe në drejtimin e vëmendjes së përdoruesit në fusha të caktuara kyçe të cilat mund të ndryshojnë nga kompania në kompani.
- Analiza e trendit, analiza horizontale dhe analiza vertikale kryhen të gjitha duke përdorur koeficientë.

**ii) Kufizimet e përdorimit të koeficientëve në vlerësimin e performancës financiare.  
(kërkohen vetem 3)**

- Përkufizime jokonsistente të koeficientëve
- Pasqyrat financiare mund të jenë manipuluar qëllimisht (kontabilitet kreativ)
- Kompani të ndryshme mund të miratojnë politika të ndryshme kontabël (p.sh. përdorimi i kostove historike krahasuar me vlerat aktuale)
- Politika të ndryshme menaxheriale (p.sh. kompani të ndryshme u ofrojnë klientëve kushte të ndryshme pagese)
- Shifrat e pasqyrës së pozitës financiare mund të mos jenë përfaqësuese të vlerave mesatare gjatë gjithë vitit (kjo mund të shkaktohet nga tregtia sezonale ose një blerje e madhe e pasurive jo-qarkulluese pranë fundit të vitit)
- Ndikimi i ndryshimeve të çmimeve me kalimin e kohës/shtrembërimi i shkaktuar nga inflacioni.

4.

a) Swensen sh.a është një kompani e listuar në bursë dhe po përgatit pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024.

Swensen sh.a planifikon të mbyllë një nga divizionet e saj. Ky divizion, i cili klasifikohet si një segment i veçantë biznesi, do të ndërpresë të gjitha aktivitetet e tij më 28 shkurt 2025. Shumica e aseteve të biznesit do të ridislokohen diku tjetër në biznesin e Swensen sh.a-së, megjithatë disa artikuj më të vegjël të fabrikës do të shiten ose do të skrapohen. Përafërsisht gjysma e stafit të divizionit do të pushohet nga puna dhe ata u njoftuan për vendimin në fund të dhjetorit 2024. Klientët dhe furnitorët u njoftuan në të njëjtën kohë. Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2024 janë planifikuar të publikohen më 9 mars 2025.

**Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët në lidhje me çështjet e raportimit financiar që rrjedhin nga mbyllja e divizionit dhe shpjegoni trajtimin e duhur në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 të Swensen sh.a.**

**(6 pikë)**

b) Greenblatt sh.a është një kompani investimi që zotëron një portofol letrash me vlerë të lidhura me tregun e pasurive të paluajtshme në Dardani. Informacioni i mëposhtëm është i disponueshëm më 31 dhjetor 2024 në lidhje me këtë portofol:

- i) Portofoli kushtoi €13 milionë 2 vjet më parë.
- ii) Çmimet e pasurive të paluajtshme në Dardani pranohet përgjithësisht se kanë rënë me 20-30% në 2 vitet e fundit.
- iii) Portofoli i letrave me vlerë të mbajtura nga Greenblatt sh.a është i vështirë për t'u vlerësuar, pasi nuk ka treg aktiv. Megjithatë, kompania ka marrë një ofertë prej €2.6 milionë për këtë portofol nga një investitor. Greenblatt sh.a nuk ka ndërmend ta pranojë këtë ofertë, megjithëse kompani të ngjashme kanë pranuar oferta nga ky investitor për shkak të vështirësive financiare..
- iv) Një shitje normale në klimën aktuale mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të gjenerojë €6 milionë bazuar në një analizë të transaksioneve në asete të ngjashme.
- v) Modelet e vlerësimit të Greenblatt sh.a sugjerojnë se tregu i pasurive të paluajtshme në Dardani do të rimëkëmbet dhe pret që portofoli të gjenerojë €12 milionë (me vlerën e tanishme) gjatë tre viteve të ardhshme.

**Kërkohet:**

**Në përputhje me SNRF 13 *Matja e Vlerës së Drejtë*, këshilloni Greenblatt sh.a mbi shumën që duhet të paraqesë portofolin e saj të investimeve në pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor 2024, duke supozuar se dëshiron të përdorë vlerën e drejtë.**

**(5 pikë)**

c) Komentimi i menaxhmentit është një raport i shkurtë që jep një kontekst Brenda të cilit mund të interpretohet pozita financiare, përformanca financiare dhe rrjedhat e parasë së një entiteti. Gjithashtu i jep menaxhmentit një mundësi për të shpjeguar objektivat e tij dhe strategjitë e tij për të arritur këto objektiva.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni shkurtimisht parimet për përgaditjen e komentimeve të menaxhmentit dhe elementet e komentimeve të menaxhmentit.** (5 pikë)

d) SNRF 11 *Aranzhimet e përbashkëta* klasifikon aranzhimet e përbashkëta ose si operacione të përbashkëta ose si sipërmarrje të përbashkëta. Ky klasifikim është i rëndësishëm që aranzhimet e përbashkëta të kontabilizohen saktë në pasqyrat financiare.

**Kërkohet:**

**Tregoni dallimin midis një sipërmarrjeje të përbashkët dhe një operacioni të përbashkët.** (4 pikë)

5.

**a) SNRF 5 Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacione të ndërprera**

Çështja këtu është nëse mbyllja e divizionit duhet të kontabilizohet si një operacion (veprimtari) i ndërprerë sipas SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacione të ndërprera*. Një veprimtari ndërprerë përkufizohet si komponent i entitetit i cili ose është larguar [shitur], ose është klasifikuar si 'i mbajtur për shitje', dhe:

- a) Paraqet një linjë të veçantë e të madhe të biznesit ose një zonë gjeografike të veprimtarive
- b) Është pjesë e një plani të vetëm të koordinuar për largimin [shitjen] e një linje të veçantë e të madhe të biznesit ose një zone gjeografike të veprimtarive; ose
- c) Është një filial i blerë ekskluzivisht për t'u rishitur:

Megenëse operacioni i ndërprerë nuk është shitur në fund të vitit, ai mund të klasifikohet si i ndërprerë në pasqyrat financiare të vitit 2024 vetëm nëse plotëson përkufizimin e 'të mbajtur për shitje'. Grupet e shitjes klasifikohen si të mbajtura për shitje nëse "vlera e tyre kontabël do të rikuperohet kryesisht përmes një transaksioni shitjeje dhe jo përmes përdorimit të vazhdueshëm".

Ky nuk është rasti këtu pasi shumica e pasurive po rishpërndahen diku tjetër në biznes.

Pasuritë e vogla mund të klasifikohen potencialisht si të mbajtura për shitje nëse plotësohen të gjitha kriteret përkatëse, por jo si një operacion (veprimtari) i ndërprerë.

**SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente**

Duhet të parashikohen kostot e shkurtimit të vendeve të punës nëse ekziston një detyrim konstruktiv në fund të vitit. Ky duket të jetë rasti, duke supozuar se është hartuar një plan formal i detajuar për ristrukturimin dhe se entiteti ka ngritur një pritje të vlefshme tek ata që preken se ristrukturimi do të kryhet duke i njoftuar ata për shkurtimin e vendeve të punës para fundit të vitit.

**SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**

Megenëse pasqyrat financiare vjetore nuk ishin planifikuar të publikoheshin deri pas mbylljes së divizionit, mbyllja duhet të shpaloset si një ngjarje jo-korigjuese pas periudhës raportuese për shkak të rëndësisë së saj për biznesin (është një segment operativ i veçantë).

**b)**

Ka një numër vlerash të mundshme që mund të përdoren këtu. Megjithatë, jo të gjitha janë të një cilësie të barabartë.

- Ekziston një ofertë për pasurinë prej €2.6 milionë. Megjithatë, Greenblatt sh.a nuk ka ndërmend ta pranojë këtë ofertë, kështu që nuk është një çmim aktiv në treg.
- Një shitje e rregullt pritet të gjenerojë €6 milionë. Kjo shifër është arritur pas analizimit të transaksioneve në pasuri të ngjashme. Prandaj, kjo duket se kualifikohet si një input i nivelit 2 dhe do të dukej e arsyeshme të përdoret si bazë e vlerësimit.

- Modelet e vlerësimit që sugjerojnë një vlerë portofoli prej €12 milionë janë të nivelit 3, pasi ato janë të pavëzhgueshme. Prandaj, ato janë inferiore ndaj inputeve të nivelit 2. Megjithatë, fakti që modelet duket se parashikojnë një rimëkëmbje do të sugjeronte që vlerësimi i përcaktuar prej tyre nuk do të ishte i arritshëm në tregun aktual. Prandaj, kjo vlerë nuk do të përmbushte përkufizimin e vlerës së drejtë të IFRS 13 *Matja e vlerës së drejtë*.

Prandaj, vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë në këtë situatë do të ishte €6 milionë.

c)

Kur një komentim i menaxhmentit ka të bëjë me pasqyrat financiare, atëherë ato pasqyra financiare duhet të jipen brenda komentimit ose komentimi duhet qartazi të identifikoj pasyrën financiare për të cilën po flet. Komentimi i menaxhmentit duhet qartazi të dallohet nga informatat tjera dhe duhet të theksoj se në çmasë ka ndjekur Deklaratën e Praktikimit.

Komentimi i menaxhmentit duhet të ndjekë këto parime:

- a) Të japë pikëpamjet e menaxhmentit për performancën, pozitën dhe progresin e entitetit,
- b) Të plotësoj dhe kompletoj informatat e prezantuara në pasqyrat financiare;
- c) Të përfshij informata që shikojnë në të ardhmen; dhe
- d) Të përfshij informata që kanë cilësi kualitative të shpjeguara në Kornizën Konceptuale

Elementet e komentimeve të menaxhmentit

Deklarata e Praktikimit thotë se për të përmbushur qëllimin e komentimit të menaxhmentit, një entitet duhet të përfshijë informata që janë thelbësore për të kuptuarit e:

- a) Natyrës së biznesit
- b) Objektivave të menaxhmentit dhe strategjive të tij për ti përmbushur këto objektiva
- c) Resurseve më të mëdha të entitetit, rreziqeve dhe marrëdhënieve
- d) Rezultateve të operacioneve dhe perspektivat
- e) Treguesve kritik të matjes së performancës që menaxhmenti përdor për të vlerësuar performancën e entitetit kundrejt objektivave të vendosura.

d)

SNRF 11 *Aranzhimet e përbashkëta* klasifikon aranzhimet e përbashkëta ose si operacione të përbashkëta ose si sipërmarrje të përbashkëta. Klasifikimi i një aranzhimi të përbashkët si një operacion i përbashkët ose si sipërmarrje e përbashkët varet nga të drejtat dhe obligimet e palëve në aranzhim.

Një operacion i përbashkët është një aranzhim i përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët (operatorët e përbashkët) kanë të drejta në pasuritë dhe obligime për detyrimet e atij aranzhimi të përbashkët. Një aranzhim i përbashkët që nuk është i strukturuar nëpërmjet një entiteti të ndarë është gjithmonë operacion i përbashkët.

Një sipërmarrje e përbashkët është një aranzhim i përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët (sipërmarrësit e përbashkët) të aranzhimit kanë të drejta në neto pasuritë e aranzhimit.

Një aranzhim i përbashkët i cili është strukturuar nëpërmjet një entiteti të ndarë mund të jetë një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët.

Për të vendosur klasifikimin, palët e aranzhimit duhet të vlerësojnë kushtet e marrëveshjes kontraktuale të aranzhimit se bashku me faktet dhe rrethanat tjera për të vlerësuar nëse ata kanë:

- Të drejta në pasuritë, dhe obligime për detyrimet, në lidhje me aranzhimin (që tregon një operacion të përbashkët)
- Të drejta në neto pasuritë e aranzhimit (që tregon një sipërmarrje të përbashkët)

5.

a) Paulson sh.a hyri në një shitje dhe marrje me qira më 1 janar 2024. Ajo shiti një paisje me një shumë të bartur prej €350,000 në para të gatshme prej €500,000 (ekuivalente me vlerën e drejtë) dhe e mori me qira përgjatë një periudhe pesëvjeçare, ekuivalente me ciklin e mbetur të dobishëm të jetës.

Transaksioni përbën një shitje në pajtim me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*.

Lizingu i ofruar për pesë pagesat vjetore me këste prej €100,000. Norma implicite e interesit në lizing është 5%.

**Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët e Paulson sh.a për trajtimin e saktë kontabël të transaksionit të mësipërm sipas SNRF 16 *Lizingjet* për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024. (6 pikë)**

b) Sipas SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*, pasuritë, detyrimet dhe detyrimet kontigjente të identifikueshme të filialeve kërkohet të përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara me vlerën e tyre të drejtë dhe jo me vlerën e tyre kontabël. Diferenca midis vlerave të drejta dhe vlerave kontabël është një rregullim konsolidimi i bërë vetëm për qëllimet e pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Kërkohet:**

**Arsyetoni përdorimin e vlerave të drejta kur një kompani prind blen një interes kontrollues në një kompani filial. (5 pikë)**

c) Një kompani prind ose kompani holding e cila ka operacione [veprimtari] në vende të huaja duhet të përkthejë pasqyrat financiare të këtyre operacioneve [veprimtarive] në valutën e vet raportuese para se filiali të fillojë konsolidimi i filialit në pasqyrat financiare të grupit.

Ekzistojnë dy metoda të mundshme: metoda e përdorur varet prej faktit nëse veprimtaria [operacioni] e huaj ka të njëjtën valutë funksionale me kompaninë prind.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni shkurtimisht konsolidimin e pasqyrave financiare në rastet kur valuta funksionale e veprimtarisë [operacionit] të huaj është e ndryshme nga ajo e kompanisë prind. (5 pikë)**

d) SNRF 3 i rishikuar e shikon grupin si një entitet ekonomik, dhe shikon të gjithë ofruesit (dhënësit) e ekuitetit, përfshirë interesat jo-kontrollues, si pronarë të grupit.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni implikimin e konsolidimit të një ndryshimi në strukturën e grupit që nuk rezulton në humbjen e kontrollit. (4 pikë)**

5.

**a) shitja dhe shitja dhe marrja me qira**

Detyrimi i lizingut në fillim do të jetë:

|                | €              |
|----------------|----------------|
| 100,000/1.05   | 95,238         |
| 100,000/1.05^2 | 90,703         |
| 100,000/1.05^3 | 86,384         |
| 100,000/1.05^4 | 82,270         |
| 100,000/1.05^5 | 78,353         |
|                | <b>432,948</b> |

Pasuria me të drejtë përdorimi =  $350,000 \times 432,948 / 500,000 = €303,064$

Fitimi nga shitja është €150,000. Nga kjo, shuma që lidhet me të drejtat e mbajtura është:

$150,000 \times 432,948 / 500,000 = 129,884$ . Saldo (€20,116) është fitimi mbi të drejtat e transferuara.

Postimi fillestar do të jetë:

|                                   | Debi<br>€      | Kredi<br>€    |
|-----------------------------------|----------------|---------------|
| Paraja e gatshme                  | 500,000        |               |
| E drejta e përdorimit të pasurisë | 303,064        |               |
| Pasuritë themelore                |                | 350,000       |
| Detyrimi                          |                | 432,948       |
| Fitimi mbi transferin             |                | <u>20,116</u> |
|                                   | <u>803,064</u> | 803,064       |

**Pasqyra e fitimit ose humbjes**

|                         | €        |
|-------------------------|----------|
| Fitimi mbi transferin   | 20,116   |
| Zhvlerësimi (432,948/5) | (86,590) |
| Interesi (LI)           | (21,647) |

**Pasqyra e pozitës financiare**

|                                              |         |
|----------------------------------------------|---------|
| Pasuritë jo-qarkulluese                      |         |
| Pasuria me të drejtë përdorimi               | 303,064 |
| Detyrimet afatgjata                          |         |
| Detyrimi i lizingut (LI)                     | 272,325 |
| Detyrimet afatshkurta                        |         |
| Detyrimi i lizingut (354,595 - 272,325) (LI) | 82,270  |

Llogaritja – detyrimi i lizingut

|                                 | €                |
|---------------------------------|------------------|
| 1 janar 2014                    | 432,948          |
| Interesi 5%                     | 21,647           |
| Kësti i paguar                  | <u>(100,000)</u> |
| Saldo 31 dhjetor 2014           | 354,595          |
| Interesi 5%                     | 17,730           |
| Kësti i paguar                  | <u>(100,000)</u> |
| <b>Saldo më 31 dhjetor 2025</b> | <b>272,325</b>   |

## **b) Vlera e drejtë e pasurive dhe detyrimeve të blera**

Pasuritë dhe detyrimet në pasqyrat financiare të një entiteti shpesh nuk deklarohen me vlerën e tyre të drejtë, për shembull, kur politika kontabël e entitetit është të përdorë modelin e koston për pasuritë. Nëse pasqyrat financiare të filialit nuk rregullohen me vlerat e tyre të drejta, ku, për shembull, vlera e një pasurie është rritur që nga blerja, emri i mirë do të mbivlerësohej (pasi do të përfshinte rritjen e vlerës së pasurisë).

Pasqyrat e konsoliduara përgatiten nga perspektiva e grupit, dhe jo nga perspektivat e kompanive individuale. Vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve të filialit janë kryesisht të parëndësishme, sepse pasqyrat e konsoliduara duhet të pasqyrojnë koston e tyre për grupin (domethënë për kompaninë prind), jo koston e tyre origjinale për filialin. Kostoja për grupin është vlera e tyre e drejtë në datën e blerjes.

Emri i mirë i blerë është diferenca midis vlerës së një entiteti të blerë dhe totalit të vlerave të drejta të pasurive dhe detyrimeve të identifikueshme të aij entiteti. Nëse nuk përdoren vlerat e drejta, vlera e emrit të mirë do të jetë e pakuptimtë.

**c) Pasqyrat financiare të veprimtarisë [operacionit] të huaj duhet të përkthehen në valutën funksionale të kompanisë prind. Në këtë rast duhet të ndiqen procedura të ndryshme, për arsye se valuta me të cilën do të duhet të përgatiten pasqyrat financiare (valuta e paraqitjes) të veprimtarisë [operacionit] të huaj është valuta funksionale e kompanisë prind.**

- a) Pasuritë dhe detyrimet që tregohen në pasqyrën e pozitës financiare të veprimtarisë [operacionit] të huaj përkthehen me kursin në fund të periudhës, pavarësisht nga data në të cilën zërat përkatës kanë dalë në pah. Shifra balancuese mbi pasqyrën e përkthyer të pozitës financiare përfaqësojnë investimin neto të entitetit raportues në veprimtarinë [operacionin] e huaj në fjalë.
- b) Shumat në pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse duhet të përkthehen me anë të kursit të këmbimit në datën e transaksionit (shpesh përdoret një kurs mesatar për qëllime praktike).
- c) Diferencat që dalin në pah nga ri – përkthimi i investimit neto të kompanisë prind në fund të secilit vit, duhet të njihen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse, jo nëpërmjet fitimit ose humbjes për vitin, deri në kohën kur investimi neto largohet nga librat [sepse shitjet ose largohet në ndonjë mënyrë tjetër]. Kur të largohen fitimet ose humbjet deri me datë riklasifikohen në fitim ose humbje.

**d) Implikimet e mëposhtme kontabël duhet të shënohen kur një IJK në një filial ndryshon, por e njëjta kompani prind ruan kontrollin:**

- nuk njihet asnjë fitim ose humbje kur kompania prind shet aksione (duke rritur kështu IJK-në)
- blerja e aksioneve shtesë në filial nga një kompani prind (duke zvogëluar kështu IJK-në) nuk rezulton në zë të mirë shtesë ose rregullime të tjera në kontabilitetin fillestar për kombinimin e biznesit
- në të dyja situatat, vlera bartëse e ekuitetit të kompanisë prind dhe pjesa e ekuitetit të IJK-së rregullohet për të pasqyruar ndryshimet në interesin e tyre relativ të pronësisë në filial. Çdo diferencë midis shumës së rregullimit të IJK-së dhe vlerës së drejtë të shumës së marrë ose të paguar njihet në ekuitet, që i atribuohet kompanisë prind.